

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		13/08/2026	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
13	400/01	33866	



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas –Municipality of Drenas
 Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë



Datë:	13.08.2026
Për:	Zyrën e Informimit
Nga:	Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë
Lënda:	Procesverbal nga shqyrtimi publik i draft-Planit Komunal për Transport Lokal në Komunën e Gllogocit 2026-2031

Me **01.07.2026**, është publikuar njoftimi për mbajtjen e konsultimit për Draft-Planin Komunal për Transportin Lokal 2026-2031. Njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës, përkatësisht tek kategoria për konsultimet publike si dhe në faqen zyrtare të Komunës së Drenasit në rrjetin social Facebook.

1. Ueb-faqja zyrtare e Komunës, në rubrikën 'Konsultimet Publike':

<https://gllogoc.rks-gov.net/draft-plani-komunal-per-transport-lokal-2026-2031-gllogoc/>

2. Platforma për Konsultime Publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/meetingsList.php>

3. Faqja zyrtare e Komunës në Facebook:

<https://www.facebook.com/komunadrenas>

Më **16.07.2026**, në faqen zyrtare të Komunës së Drenasit në rrjetin social Facebook është publikuar rikujtimi i njoftimit për mbajtjen e konsultimit publik dhe, në të njëjtën ditë, kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve u është dërguar njoftimi edhe përmes telefonit.

Më datë **17.07.2026** mbahet konsultimi publik në sallën e Kuvendit Komunal.

Konsultimi publik filloi në orën 14:00, në sallën e Kuvendit Komunal të Drenasit.

Konsultimin e shpalli të hapur z. Bekim Dobra, Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun, lidhur me Draft Planin Komunal për Transportin Lokal. Ai falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje dhe i njoftoi për qëllimin e konsultimit publik, rëndësinë e përfshirjes së qytetarëve dhe grupeve të interesit në procesin e

hartimit të dokumenteve strategjike, si dhe për afatet ligjore për paraqitjen e komenteve dhe sugjerimeve. Komuna kishte bërë njoftimin publik 15 ditë më parë dhe kishte publikuar edhe linkun e draft-dokumentit, në mënyrë që secili qytetar të kishte mundësi ta shqyrtonte përmbajtjen e tij dhe të paraqiste komentet dhe sugjerimet. Duke qenë se dokumenti është ende në fazën e draftit, qytetarët u ftuan të japin komentet, sugjerimet dhe rekomandimet e tyre, me qëllim që ato të inkorporohen në Draft Planin Komunal për Transportin Lokal.

Fillimisht, fjala iu dha drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, z. Nexhmedin Gruda, e më pas shefit të sektorit, z. Afrim Prokshi, për prezantimin e draft-planit.

Z. Gruda falënderoi të gjithë të pranishmit që kishin gjetur kohë të merrnin pjesë në konsultimin publik për Draft Planin Komunal për Transportin Lokal. Ai theksoi se deri në atë moment nuk ishte pranuar asnjë koment apo sugjerim në adresën elektronike të drejtorisë dhe i ftoi të pranishmit që, pas prezantimit të dokumentit, të ndiheshin të lirë të paraqisnin çdo koment apo sugjerim të vlefshëm, i cili mund të përfshihej në draft-plan para se ai të procedohej për miratim në Kuvendin Komunal.

Për një prezantim më të detajuar të Draft Planit Komunal për Transportin Lokal, fjala iu dha shefit të sektorit në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, z. Afrim Prokshi, i cili falënderoi të pranishmit dhe paraqiti përmbajtjen e draft-planit në pika të shkurtra si më poshtë:

Prioritetet e PKTL-së

Prioritetet e Planit Komunal të Transportit Lokal janë:

1. Shtrirja e shërbimit të transportit të udhëtarëve me autobus dhe autotaksi në të gjithë territorin e Komunës së Glllogocit;
2. Përmirësimi i ofrimit të shërbimit në transportin publik të udhëtarëve, në vijat e rregullta dhe ato jashtëlinjore, sipas ligjeve në fuqi dhe Rregullores komunale nr. 06-7086, të dt. 19.02.2014, për transportin publik të udhëtarëve;
3. Hartimi i rendeve të udhëtimit dhe respektimi i tyre për ofrimin e një shërbimi më efikas në transportin publik të udhëtarëve;
4. Ndalimi i mbingarkesës për operatorët me autobusë, minibusë dhe autotaksi;
5. Ndërtimi dhe sinjalizimi horizontal e vertikal i vendndalesave për autobusë, si dhe mirëmbajtja e tyre, përkatësisht e vendparkimeve të autobusëve, minibusëve dhe autotaksive;
6. Përmirësimi i qasjes për persona me aftësi të kufizuara (PAK);
7. Ndërtimi, zgjerimi dhe mirëmbajtja e parkingjeve publike.

Vizioni i PKTL

Glllogoci me një sistem transporti lokal të integruar dhe të sigurt, me rrugë funksionale, transport publik efikas, infrastrukturë për këmbësorë dhe biçikleta, që redukton trafikun, ndotjen dhe kohën e udhëtimit ndërmjet fshatrave dhe qendrës urbane.

Synimi i PKTL

Synimi i këtij plani është zhvillimi i një sistemi të qëndrueshëm, të sigurt dhe efikas të transportit në Glllogoc, i cili përmirëson qasjen dhe lëvizshmërinë për qytetarët, rrit sigurinë në komunikacion, lehtëson lidhjen ndërmjet zonave urbane dhe rurale, si dhe mbështet zhvillimin ekonomik dhe mbrojtjen e mjedisit.

Objektivat dhe caqet e Planit

PKTL-ja përmban gjashtë objektiva si me poshtë:

Objektivi 1: Mbulueshmëria e vendbanimeve të komunës me transport publik të udhëtarëve

Objektivi 2: Shenjzimi dhe mirëmbajtja e vendndaljeve ekzistuese të autobusëve.

Objektivi 3: Ndërtimi i vendndalimeve jashtë shiritit rrugor për autobusë dhe bus- kabinave për udhëtarë

Objektivi 4: Forcimi institucional dhe financimi i sektorit të transportit:

- Partneritete publiko-private.
- Plan investiv për infrastrukturë të transportit rrugor.
- Koordinim komunë–nivël qendror për projekte prioritare

Objektivi 5: Përmirësimi i qasjes për persona me aftësi të kufizuara

Objektivi 6: Eliminimi i transportit ilegal dhe vendndaljeve ilegale të autobusëve

Gjithashtu, theksoi se në plan është i paraparë edhe plani financiar i veprimit dhe i monitorimit për vitet 2026–2031, sipas objektivave përkatëse, në tabelën në faqe 66 të PKTL.

Pas përfundimit të prezantimit të draft-planit nga shefi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, z. Bekim Dobra hapi debatin lidhur me propozimet dhe komentet e qytetarëve.

Hafiz Muja – Administrator i fshatrave Gradicë dhe Likoshan – Përsëhendetje për të gjithë dhe faleminderit për ftesën. E kemi shqyrtuar draft-planin dhe konsiderojmë se është një dokument i punuar mirë. Kërkojmë nga Komuna që, për të ardhmen, të shqyrtojë mundësinë e subvencionimit të operatorëve, në mënyrë që të mund të operojnë pa pengesa, për shkak të numrit të vogël të udhëtarëve.

Habib Gashi – Administrator i fshatit Nekoc – Përsëhendetje për të gjithë të pranishmit. Kemi një kërkesë për Komunën dhe Ministrinë përkatëse lidhur me rrugën Komoran–Carralevë, e cila paraqet rrezik të shtuar për shkak të shpejtësisë së lëvizjes së automjeteve dhe mungesës së vendndaljeve për autobusë. Kjo situatë paraqet rrezik për aksident, si për automjetet, ashtu edhe për këmbësorët.

Pas dëgjimit të komenteve dhe kërkesave të qytetarëve, përgjigje dhanë drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, z. Nexhmedin Gruda, dhe shefi i sektorit, z. Afrim Prokshi.

Z. Gruda theksoi se të gjitha shqetësimet e ngritura do të merren në konsideratë dhe shtoi se Komuna është duke shqyrtuar mundësinë e subvencionimit të operatorëve që operojnë në fshatrat me numër më të vogël udhëtarësh. Sa i përket vendndaljeve në rrugën Komoran–Carralevë, ai sqaroi se Komuna ka komunikim të vazhdueshëm me Drejtorinë e Rrugëve në kuadër të ministrisë përgjegjëse dhe se janë dërguar kërkesa lidhur me dëmtimet e rrugëve dhe vendndaljet e autobusëve. Ai theksoi se do të parashtrohet përsëri kërkesë, pasi kjo çështje nuk është në kompetencë të Komunës.

Ndërsa, z. Prokshi theksoi se do të shqyrtohen format e mundshme të subvencionimit dhe se në plan, tek objektivat, është paraparë një gjë e tillë, si dhe gjatë procedurës së re të kontraktimit do të zhvillohen bisedime me secilin operator që aplikon, me qëllim të gjetjes së një zgjidhjeje të përshtatshme për një mënyrë të subvencionimit.

Takimin e mbylli Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, z. Bekim Dobra, duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje dhe angazhimin e tyre në këtë konsultim publik. Ai njoftoi se Draft Plani Komunal për Transportin Lokal do të mbetet në shqyrtim publik deri më 20.07.2026, në orën 16:00, dhe se të gjithë të interesuarit mund t'i dërgojnë komentet dhe sugjerimet e tyre në adresën elektronike të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, për ndryshimin ose plotësimin e këtij draft-dokumenti.

Konsultimi publik përfundoi në orën 14:40.

Tema	Zyra	Pjesëmarrës	Vendi Data	Komentet	Njoftimi
Draft - Plani komunal për transportin lokal 2026-2031	Zyra e Kryetarit Zyra për Informim Zyra e Kuvendit	F M 18 16	Salla e Kuvendit	2 komente 0 të pranuara 0 të papranuara	1. https://gllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/07/Njoftim-per-Konsultim-Publik.pdf

Bashkëngjitur me këtë raport janë edhe këto dokumente:

1. Njoftimi për mbajtjen e konsultimit publik;
2. Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik.

Përgatiti:

Bahtije Spahiu

Anëtare e Grupit Punues





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas-Municipality of Drenas



Nr. 01-060/d-25395 Datë: 01/07/2026

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Drenasit (Glllogocit), 01 Nr. 110-6904, si dhe nenin 19 të Udhëzimit Administrativ (MAPI) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, Komuna e Glllogocit lëshon këtë:

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

Lidhur me organizimin e konsultimit publik me qytetarët për **Draft-Planin Komunal për Transportin Lokal në Komunën e Glllogocit 2026-2031**.

Draft-Plani Komunal për Transportin Lokal do të jetë në konsultim publik nga data **01.07.2026** deri më **20.07.2026**. Konsultimi publik me qytetarët do të mbahet më **17.07.2026**, në Sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora **14:00**.

Të gjitha komentet dhe sugjerimet tuaja mund t'i dërgoni deri më **20.07.2026**, ora 16:00, në adresën elektronike: nexhmedin.gruda@rks-gov.net.

Për më shumë informata në lidhje me **Draft-Planin Komunal për Transportin Lokal në Komunën e Glllogocit 2026-2031**, dokumentin për konsultim publik mund ta gjeni në këto lidhje:

Ueb-faqja zyrtare e Komunës, në rubrikën 'Konsultimet Publike':

<https://glllogoc.rks-gov.net/draft-plani-komunal-per-transport-lokal-2026-2031-glllogoc/>

Platforma për Konsultime Publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/meetingsList.php>

Faqja zyrtare e Komunës në Facebook:

<https://www.facebook.com/komunadrenas>



Artan Hasani

Zyra për Komunikim me Publikun



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas-Municipality of Drenas



Lista e pjesëmarrësve në Konsultimin Publik për Draft-Planin Komunal për Transportin Lokal në Komunën e Drenasit (Glllogocit) 2026-2031, datë: 17.07.2026

Nr.	Emri	Mbiemri	Gjinia M F	Nënshkrimi
1.	Arbenite	Lama	F	
2.	Bakim	Dobra	M	
3.	Thkendiye	Thagi	F	
4.	BESART	BAJRAMI	M	
5.	SHABAN	DOBRA	M	
6.	GRANIT	ELSHANI	M	
7.	HAFIZ	MUJA	M	
8.	HASRUSH	MUSLISA	M	
9.	Kushtrim	Kastrati	M	
10.	Bahrije	Spahiu	F	
11.	Antigona	Durmishi	F	
12.	AFIDE	VEJELI - BERISHA	F	
13.	ADELINË	DERVISHI	F	
14.	Vlora	Zuçaku - Morina	F	
15.	FLORIM	GELI	M	
16.	HABIB	GASHI	M	
17.	Hasime	Gashi	F	
18.	Anjeza	Plataj	F	
19.	Erjona	Krasnigi	F	
20.	Valmire Morina	Shala	F	
21.	Besim Mustafi		M	
22.	Adrim Proshi		M	
23.	Liridon	Berisha	M	
24.	Djelkiza	Gj/ky	F	
25.	Antigona	Bucolli	F	
26.	GRANIT	KARAGICA	M	



27.	Burbuge	Hoxha	F	Burthure
28.	Valentina	Bylykbashi	F	Bylykbashi
29.	GEZIN	HASDINI	M	Hasdini
30.	Arblinda	Murtez	F	Arblinda
31.	SHUKRIE	Azu	F	Shukrie
32.	Kaltrin	Qerkinaj	F	Kaltrin
33.	Enver	Hoxha	M	Enver
34.	Krian	Krisaj	M	Krian
35.				
36.				
37.				
38.				
39.				
40.				
41.				
42.				
43.				
44.				
45.				
46.				
47.				
48.				
49.				
50.				
51.				
52.				
53.				
54.				
55.				
56.				
57.				
58.				
59.				
60.				
61.				
62.				

* Në këtë takim, përveç kësaj liste, do të bëhen fotografi dhe, me nënshkrimin tuaj, pajtoheni që fotografitë dhe kjo listë të përdoren për komunikim zyrtar.

